

QKB

STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "RSS Alb" SH.P.K

Sot më datë 02.03.2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë) ortakët e shoqërisë "RSS Alb" sh.p.k e ndodhur në Tiranë në adresën: Kastrati Hotel & Tower, sheshi "Italia Tirana 1000" me vullnet të plotë dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar vendosën themelimin e shoqërisë, bazuar në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Ligjin Nr 135/2015 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Ortakët themelues:

1. Medea Kastrati: atësia Vexhi Muçmataj, amësia Frida Muçmataj, e lindur në Vlorë më datë 13.07.1987 banuese në Tiranë, në adresën Vilat "Rolling Hills", Nr.81, Komuna Petrelë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar identiteti i të cilit provohet me numër pasaporte Nr.BI0672802 dhe Nr.Personal I75713016M
2. Ada Ziu: atësia Agim, amësia Luljeta, e lindur në Berat më datë 02.05.1987 banuese në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.12, Rruga "Hamdi Gurunja", Pall.5 madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar identiteti i të cilit provohet me letërnjoftimin me Nr. 028749008 dhe Nr.Personal I75502087B

KREU I

Ortakët e Shoqërisë

Neni 1

Shoqëria "RSS Alb" sh.p.k themelohet nga dy ortakë të cilët janë persona fizik dhe konkretisht:

1. Medea Kastrati
2. Ada Ziu

Me gjeneralitete të shprehur si më sipër.





KREU II

Emërtimi i Shoqërisë

Neni 2

Emërtimi i shoqërisë është “RSS Alb” sh.p.k (më poshtë referuar si shoqëria)

KREU III

JURIDKSIONI, KOHËZGJATJA, QENDRA E VEPRIMTARISË DHE SIMBOLET.

Neni 3

Territori ku do të zhvillojë veprimtarinë e saj shoqëria “RSS Alb” sh.p.k është në adresën Kastrati Hotel & Tower, Sheshi “Italia Tirana 1000” (selia kryesore).

Neni 4

Veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvillojë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë aty ku do jetë e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të saj sipas objektit të veprimtarisë.

Neni 5

Qendra e shoqërisë ndodhet në Tiranë. Shoqëria mund të hapë degë apo zyra në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 6

Shoqëria, ka vulën dhe simbolet e saj të cilat do të jenë në funksion pas ditës së regjistrimit dhe themelimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

KREU IV

Neni 7

Forma Ligjore

Shoqëria do të jetë shoqëri e së drejtës Shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.



KREU V
KOHËZGJATJA

Neni 8

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të papërcaktuar.

KREU VI

OBJEKTI

Neni 9

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj:

- a) shërbime në fushën e sigurisë në transportin rrugor
- b) kontroll automatik dhe administrim mbi penalitetet për kundrvatjet rrugore
- c) çdo operacion financiar, tregtar, shërbimi, industrial, me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që mund të lidhen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, me një nga objektet e sipërpërmendura. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër të nevojshëm apo të dobishëm, për realizimin e qëllimeve të saj, si dhe çdo veprimtari tjetër që nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

KREU VII

KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT

Neni 10

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.

Ky kapital prej 100 lekë është i ndarë në dy kuota. Kuotat kanë vlerë respektive 60 lekë e cila mbahet nga zotëruesi Znj.Medea Kastrati dhe 40 lekë e cila mbahet nga zotëruesi Znj.Ada Ziu.

Pjesëmarrja e themelueseve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm.

Ortaku themelues Znj. Medea Kastrati zotëron 1 (një) kuotë që përbën 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues Znj. Ada Ziu zotëron 1 (një) kuotë që përbën 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



KREU VII

STRUKTURA DREJTUESE TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 11

Përgjegjësia e Kufizuar

Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre takuese në raport me kapitalin e shoqërisë. Shoqëria ka përgjegjësi vetëm për detyrimet mbi pasuritë që disponon në emër të saj, qofshin këto pasuri të luajtshme apo të paluajtshme.

Neni 12

Të drejta të lidhura me çdo kuotë

Çdo pjesë e secilit ortak do ti përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjen e ortakëve dhe do ti japë ortakut të drejtën për të marrë dividend në rast se do të shpërndahet fitimi me akt ekspertimi si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidim të shoqërisë.

KREU VIII

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË “RSS Alb” sh.p.k

Neni 13

E drejta e pjesëmarrjes në mbledhje

Ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e shoqërisë në mbledhjet e saj dhe të ushtrojnë të drejtat ligjore që njeh ky statut dhe ligji, përsa nuk parashikohet në statut.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e shoqërisë personalisht ose nëpërmjet një personi përfaqësues me prokurë, të informohet mbi çështjet e shoqërisë si dhe të

inspektojë dhe kontrollojë librat dhe regjistrat e shoqërisë, përveç rasteve kur është e detyrueshme pjesëmarrja personalisht.

Neni 14

Detyrimet e ortakut

Ortakët kanë detyrimin të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëse ftohen, në mënyrën e duhur të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

Neni 15

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.

Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.

Vetëm Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:

- a) Ndryshime dhe modifikime në Statut
- b) Pranimin e ortakëve të rinj (me rritje kapitali apo transferim të kuotës)
- c) Vendimin mbi përjashtimin e një ortakut në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore
- d) Të japë të drejtë nënshkrimi dhe/ose mundësi zëvendësimi për aksionet në shoqëri
- e) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar dhe/ose çdo lloj tjetër pagimi të pjesshëm ose subvencion të dhënë nga ortakët
- f) Bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë
- g) Blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja
- h) Hapjen apo mbylljen e degëve të përfaqësimit
- i) Miratimin e raporteve vjetore dhe bilancin e shoqërisë, si dhe shpërndarjen e fitimit
- j) Blerjen shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme
- k) Bashkëpunimin apo krijimin e join-venture me shoqëri të tjera të huaja apo vendase
- l) Marrjen me qira, dhënien me qira të pasurive të saj të tashme apo të ardhme me të drejtë përdorimi
- m) Të vendosë për investimet
- n) Të përcaktoj politikat e shoqërisë
- o) Të japë apo të heq prokura apo autorizime për punonjësit apo për të tretët
- p) Të caktoj shërbimet dhe funksionet e administratorit apo administratorëve

- q) Te përfundojë kontratën me administratorin si dhe kontratat e punës me nëpunësit ekzekutiv
- r) Të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi
- s) Caktimin e auditorëve, ekspertit kontabël dhe likujduesit
- t) Miratimin e rregullores së brendshme mbi administrimin
- u) Ngritjen e padive kundër anëtarëve të organeve të shoqërisë apo ortakëve
- v) Përkatimin e strukturës organizative dhe administrimin e shoqërisë
- w) Përcaktimin e buxhetit
- x) Miratimin e çdo lloj çështjeje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar Asamblesë së ortakëve, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në ditën e themelimit

Asambleja e Përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi çështje që tejkalojnë administrimin e përditshëm të shoqërisë dhe ndikojnë drejtpërdrejtë mbi të.

Neni 16

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

Vendimet e renditura për sa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimit, zvogëlimit të kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 17

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.

Gjithashtu ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të totalit të votave në Asamblesë të Përgjithshme të shoqërisë mund të drejtohen administratorëve me një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur Asamblesë të Përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posaçme të rendit të ditës të cilat duhet të njoftohen para.

Asambleja e Përgjithshme do të thirret me anë të njoftimit të shkruar të dërguar nga administratorët. Njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letër rekomande, telexi apo faksi, në jo më pak se 7 ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njejtat kushte dhe afate.

Njoftimi për takimin e Asamblesë së Përgjithshme do të tregojë datën, kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës dhe në rastin e një asambleje të zakonshme të ortakëve do të përfshijë gjithashtu dhe pasqyrat financiare dhe raportin e administratorit.

Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblese është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qenë prezent atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.

Nëse të gjithë ortakët janë prezent në asamblenë e ortakëve atëherë vendimet mund të merren edhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë janë dakort.



Neni 18

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Vendimet në Asamblenë e Përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

Prokura duhet të jetë e noterizuar dhe të paraqitet në mbledhjen e asamblesë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Çdo ortak ka të drejtë të thërrasë keshilltarë në mbledhjen e asamblesë të cilët do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.

Nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur korumin atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 dite me të njëjtin rend dite. Mbledhja e dytë e ortakëve ka të drejtë të marrë vendime mbi çështjet e caktuara në rendin e ditës pavarësisht nga kuorumi (numri i kuotave të përfaqësuara).

Vendimet e mbledhjes së ortakëve mund të merren dhe pa takimin e ortakëve, psh me anë të korrespondencës së shkruar, telekonferencës, videokonferencës dhe mënyra të tjera të mundshme nëse të gjithë ortakët kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak dhe identiteti i ortakëve mund të përcaktohet në mënyrë të padyshimtë.

Neni 19

Drejtimi dhe mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Kryetari i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të caktohet nga ortakët.

Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblesë. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

Neni 20

Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Për çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do ti dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.

Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

KREU IX

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 21

Administrimi i shoqërisë

Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose më shumë administrator të cilët do të përfaqësojnë shoqërinë. Gjithashtu Asambleja e Përgjithshme mund ti caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.

Administratorët mund të autorizojnë palet e treta që ti përfaqësojnë ata në transaksione të veçanta.

Administratorët do të organizojnë dhe manaxhojnë të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë shoqërinë në të gjitha çështjet që kane lidhje me të.



Të drejtat dhe detyrimet e administratoreve burojnë nga ligji, ky statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të shoqërisë.

Duke patur parasysh kufizimet e Nenit 12 më sipër administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:

- a) Përfaqësojnë shoqërinë kundrejt palëve të treta dhe organeve apo entitete shtetërore
- b) Hapin llogaritë bankare të shoqërisë me bankat
- c) Marrjen e huave në emër të shoqërisë dhe vendosjen e kushteve të huasë vetëm pas një vendimi të marrë në Asamblenë e Përgjithshme.
- d) Përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave
- e) Përfundimin e marrëveshjeve me palë të treta
- f) Lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave
- g) Nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesa etj, pagimin e detyrimeve të shoqërisë.
- h) Mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies
- i) Heqjen dore nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies që shoqëria ka me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive
- j) Punësimin dhe shkarkimin e stafit të shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit
- k) Marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së shoqërisë në rast të padive kundër saj
- l) Administratori mund të urdhërojë caktim avokatësh për mbrojtjen e interesave të shoqërisë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre; ai mund të tërhiqet nga padia, të nënshkruaj ato, të nënshkruajë marrëveshje zgjidhje me pajtim, marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të terheqë padinë e ngritur dhe të nderpresë procedimet
- m) Administratorët kanë të drejtë të marrin çdo veprim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të shoqërisë nga pikpamja e ligjit dhe e këtij statuti
- n) Mbledhjen e shpenzimeve të shoqërisë
- o) Mban në menyre të rregull të gjitha llogaritë e shoqërisë
- p) Administratori është përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilanceve vjetore dhe pasqyrave vjetore financiare të shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse diçka e kësaj lloji kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve
- q) Thirrjen e mbledhjes së ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të veçanta
- r) Publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e paqyrave vjetore financiare
- s) Administrimin dhe mbajtjen e rregullt të dokumentacionit të shoqërisë
- t) Vendime mbi të gjitha çështjet e aktivitetit të brendshëm të shoqërisë dhe marrëdhëniet me jashtë



- u) Vendos ne dijeni Asamblene e Pergjithshme nese kupton se shoqëria në një kohë afatmesme apo afatshkurtër mund të gjendet në pamundësinë e aftësisë paguese.
- v) Nuk lejon abuzimin me formën e shoqërisë së ndonjërit prej ortakëve

Personi në cilesinë e administratorit do të përcaktohet për një periudhë prej 5 vitesh me të drejtë ripërtëritje.

1. Leonard Kastrati, atësia Shefqet Kastrati, amësia Nazlije Kastrati, i lindur në Kukës më datë 19.11.1984, banues në Tiranë, në adresën Vilat "Rolling Hills" Nr.81, Komuna Petrelë, madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identiteti i të cilit provohet me Pasaportë me Nr.DC3436812 dhe Nr.Personal I41119082D

Specimenti i nënshkrimit të administratorit

Z. Leonard Kastrati



(emër mbiemër firmë)

Afati i emërimit të administratorit fillon nga data 02/03/2018 deri më 01/03/2023.

KREU X

VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 22

Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

Viti financiar i shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon ne ditën e parë te Janarit dhe mbaron ne të tridhjetën ditë të Dhjetorit. Viti i parë financiarë i shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron në datën 31 (tridhjetë e një) Dhjetor.

Në fund të çdo viti financiarë, administratori do të përmbushë detyrat e mëposhtme:

- a) Përgatit listen e detajuar të aseteve të shoqërisë dhe strukturës së tyre
- b) Përgatit bilancin e shoqërisë, i cili pershkruan situatën fianciare
- c) Përgatit llogaritje të fitimit, të humbjeve dhe kredive apo huave tek të tretët dhe nga të tretët

- d) Vlerëson së bashku me ekspertin e caktuar planin financiarë për tja parashtruar asamblesë pas analizimit të gjendjes në mënyrë që të vlerësohen investimet, shtimi apo pakesimi i kapitalit, falimentimi, riorganizimi etj.

Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të Asamblesë së Ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

Neni 23

Fitimi i Shoqërisë

Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahej në përputhje me pjesët e kapitalit në shoqëri.

Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimin e rezervës ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga Asambleja e Ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

Neni 24

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin financiar të shoqërisë si atë periodik dhe atë vjetor sipas detyrave të caktuara nga ortakët.

Në përfundim të hetimit eksperti përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë të kontrollit periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar tja paraqesë e dorëzojë ortakëve për ti shqyrtuar dhe për ti miratuar mbi bazën e të drejtave vendimmarrëse që kanë.

KREU XI

PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 25

Prishja dhe likujdimi

Shoqëria do të prishet në rastet e mëposhtme:

- a) Vendimi i Asamblesë së Ortakëve
- b) Bashkimi me një shoqëri tjetër
- c) Vendimi i gjykatës me juridiksionin përkatës në rastet e parashikuara në ligj
- d) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara në ligj.

Likujdimi i shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

KREU XII
TË PËRGJITISHME

Neni 26

Të Përgjithshme

Në rast mosmarrëveshje të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit ortakët do të përpiqen ti zgjidhin ato miqësisht dhe me mirëkuptim. Nëse nuk do arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksionin përkatës.

Ligji zbatues është ligji shqiptar.

Ky statut dhe akt themelimi hartohet dhe nënshkruhet në 4 kopje origjinale.

Për sa më sipër u përpilua ky statut dhe akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "RSS Alb" sh.p.k, i cili u lexua me zë të lartë nga palët dhe u kuptua dhe sipas vullnetit të lirë dhe të plotë të ortakëve themelues nënshkruhet prej tyre rregullisht në prani të palëve.


Ky statut dhe akt themelimi gjendet në përputhje me ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "RSS Alb" SH.P.K

MEDEA KASTRATI


(emër mbijemër firmë)

ADA ZIU


(emër mbijemër firmë)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE ERMIRA B. KAPLLANI

ADRESA: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla II, Kati I

Mob. 067 25 77 372;

e-mail: ermirakapllani@hotmail.com

Nr. 534 Rep



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me date 06.03/2018 (dymije e tetembedhjete), ne Tirane, une Notere Ermira B. KAPLLANI, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, shkova ne adresen: Zyra e Karburant Kastrati ne Tiranen e Re, perballe me pallatin me shigjeta, me kerkese te te poshteshenuarve:

Znj. Medea Kastrati, shtetase shqiptare, atesia Vexhi Muçmataj, lindur ne Vlore, me 13.07.1987, banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet Pasaportes Biometrike nr. BI0672802 dhe numer personal I75713016M, madhorE e me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Znj. Ada Ziu, shtetase shqiptare, atesia Agim, lindur ne Berat, me 02.05.1987, banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet Leternjoftimit nr. 028749008 dhe numer personal I75502087B, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilat, me vullnet te lire e te plote dhe nen pergjegjesine e tyre personale dhe ligjore, deklaruan se me cilesine e ortakeve themelues te Shoqerise "RSS Alb" sh.p.k., ka nenshkruar aktet per themelimin e kesaj shoqerise e qe jane bashkelidhur ketij vertetim nenshkrimi. Pa asnje rezerve, te dyja ortaket e shoqerise, i nenshkruajne keto akte para meje Noteres.

Unë Noterja, pasi bëra verifikimin e vullnetit te lire e te plote te shtetaseve te lartecituara, vullnetit te tyre per te nenshkruar aktin sa me lart, pas verifikimit te dokumenteve te tyre te identifikimit, nenshkrimin me vullnet te lire te aktit bashkelidhur, mbeshtetur ne Ligjin nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" i ndryshuar, vërtetoj nenshkrimin e tyre.

NOTERE
ERMIRA B. KAPLLANI

Ermira B. Kapllani



[Signature]